



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

Korçë, më 04/12/2017

TAKIM PËR BUXHETIMIN ME PJESËMARRJE ME BANORËT E QYTETIT TË KORÇËS

Bazuar në Ligji 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Ligji 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, në vijim të procesit të përgatitjes së projektbuxhetit për vitin 2018, zhvilluam një takim në datë 04/12/2017 me banorët e qytetit të Korçës.

Në takim morën pjesë: Kryetari i Bashkisë Sotiraq Filo, staf i bashkisë, banorë të qytetit të Korçës dhe organizata të tjera të interesuara, për të vendosur së bashku prioritetet e investimeve me qëllim përmirësimin e jetesës.

Gjatë takimit, banorët sollën në vëmendje dhe shqyrtuan së bashku disa kërkesa dhe problematika të listuara si më poshtë:

- Sistemimi i minifushës sportive në shkolla “Sotir Gura”.
- Rehabilitimi i zonës së quajtur “gropa” në lagjen 17.
- Sistemim-asfaltim i rrugëve dytësore në lagjen 9.
- Rehabilitimi i kanaleve të ujrave të zeza në rruga e Voskopojës.
- Përmirësimi i ndriçimit në lagjen 10, rruga “Theodhor Kavaljoti”.
- Sistemim-asfaltim i rrugëve në lagjen 13 dhe në lagjen 4 (zona e ish-fushës së druve).

Buxhetimi me pjesëmarrje është një mekanizëm që lejon qytetarët të marrin pjesë në vendimmarrje dhe ngritjen e transparencës në procesin e hartimit të buxhetit.







